



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 774/1 prot.

Gjirokastrë, më 03.09.2025

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET
Përmet

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek prefekti i qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendim nr. 68, datë 29.8.2025 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, konfirmohet.
2. Vendim nr. 69, datë 29.8.2025 “Për miratimin e Strategjisë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Bashkinë Përmet”, konfirmohet.
3. Vendim nr. 70, datë 29.8.2025 “Për miratimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Përmet për vitin 2025-2027”, konfirmohet.
4. Vendim nr. 71, datë 29.8.2025 “Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
5. Vendim nr. 72, datë 29.8.2025 “Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, muaji gusht 2025”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
6. Vendim nr. 73, datë 29.8.2025 “Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për dhënie ndihme financiare”, konfirmohet.

7. Vendim nr. 74, datë 29.8.2025 “Për një ndryshim në VKB nr. 47, datë 2.6.2025 ‘Për miratimin e programit kulturor dhe argëtues për periudhën shtator-dhjetor dhe akordimin e fondit përkatës”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Odise Kote

